

BURIMI JETEPRITES

Mbrëmësorja nis gjithashtu si e Pashkës së Madhe.

DHJAKU: Beko, o Atë.

PRIFTI: Lavdi Trinisë së bashkëqënshime, jetëbërëse, dhe së pandarë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

Pastaj këndohet Tropari i Pashkës me Vargjet si ditën e Pashkës, pastaj vazhdon Litanja e Madhe, dhe Thirrtoret, katër të Tingëllit Tërthor II, dhe katër të Burimit Jetëprites:

PAS OLIN APOTHEMENI, T.T.II.

Që në mëngjes gjer mbrëmëne le të shpërenjë Israeli me Zotin.

Gjëra të çudiçime, janë mbaruar prej Zotit, Shën Mari Hyjlindëse, Virgjëresh' e ndriçime, se që lartazi; zbriti ves' e qiellit, edhe Shpirt' i Shenjtë, edhe linde Zotin Krisht për ne, o burim i hireve, që vadit luadhet e Kishëve: dhuron shërim dhe ngushëllim, dhe përndan

pa reshtur gëzim kudo; pra më ty përikim, se jemi të sëmur' e në rezik, falna shëndetin e trupeve, dritën e shpirteve.

Se Zoti ka mëshirë, dhe ay do ta çpërblenjë Israelin nga të gjitha paudhësitë.

Gjëra të çudiçime, janë mbaruar prej Zotit, Shën Mari Hyjlindëse, Virgjëresh' e ndriçime, se që lartazi; zbriti ves' e qiellit, edhe Shpirt' i Shenjtë, edhe linde Zotin Krisht për ne, o burim i hireve, që vadit luadhet e Kishëve; dhuron shërim dhe ngushëllim, dhe përndan pa reshtur gëzim kudo; pra më ty përikim, se jemi të sëmur' e në rezik, falna shëndetin e trupeve, dritën e shpirteve.

Lavdërojeni Zotin gjithë kombet; lavdërojeni gjithë popujtë.

Manna e besnikëve, o Virgjëresh' e Parajsës, dhe burim i qiellit, je o Kryezonjë Perëndilindëse; se përndan kudo mi dhe, më të katër anët, çdo dhuratë dhe çdo hir për ne, ke fituar fam' e nam, më çudit' e panëmëruara; pra më ty përikim, se jemi të sëmur' e në rezik, falna shëndetin e trupeve, dritën e shpirteve.

Se ka patur mëshirë të madhe për ne, dhe e vërteta e Zotit mbrëtëron për jetë.

Valat e shërimeve, o Shën Mari Virgjëreshë, pa kursim po u buron, gjithë të sëmurëve dhe besnikëve; darovisht po rrjeth për ne, dhe përndan dhurata, për të gjith' ata që vuajnë, sy u jep të verbërve, këmbët ua ndreqe të çalëve; dhe frym' u jep të mbyturve, ngre përpjet' ulokun të vdekurin; pra më ty përikim, se jemi të sëmur' e në rezik, falna shëndetin e trupeve, dritën e shpirteve.

LAVDI, T. T. II. Kush munt t' i tregonjë, çudirat e panumërta, dhe shërimet e perëndishme, që ke vepëruar, o Burim Jetëpritis? Na i ke larguar sëmundjet, na i ke larë shpirtet, edhe na dhurove përdëllimin e math.

TANI. Cili s' të lumëron tani, Shën Mari Virgjëreshë? (**Shiko Kremtoren, f. 110-111**)

Në këtë mes behet Hyrja e Vogël kështu: Prifti dhe Dhjaku dalin nga dera e veriut, Dhjaku me Temjanicën dhe me Manalin përpara, dhe Prifti pas, dhe qëndrojnë përpara Derës së Bukur. Dhjaku bën shenjën e Kryqit me Temjanicën, dhe Prifti bekon Hyrjen. Pastaj Dhjaku thotë me zë të lartë:

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë.

Pastaj Prifti dhe Dhjaku hyjnë në Shenjtëroren, Dhjaku temjanis Alltarin, dhe Kori këndon:

KORI: Dritë gazmore e lavdisë qjellore. . . .

Pastaj Dhjaku thotë me zë të lartë:

DHJAKU: Parëvargu i mbrëmës.

PAREVARGU, T. R.

KORI: Do të dua o Zot o forca ime, o Zot o shigurimi im, dhe përikja ime dhe Shpëtimtari im. (**3 herë**)

Pastaj këndohen:

PASVARGJET

T.T.II. Ngjalljen tënde të Shenjtë o Zoti Krisht, Engjëjt' e hymnojnë me brohori; vlerësona edhe ne përmi dhenë sot, të të këndojmë me zëmër të paqme.

PAS KHERIS ASKITIKON

T.T.I. Lum' ti o jetëprurës Burim, që nëpër detet, me çudi ke fituar nam, në gjithë viset e botës, o Oqean shpirtëror, dhe ke kapërcyer, Nilin në Misir; në derdhjen e hireve, u-tregove një Silloam, liqen i bukur, i rrethuar prej maleve, edhe more hir, si Jordani për vepërim; manna e shkretëtirave, që bie nga qielli, për çdo besnik që të lutet, pa reshtur kurrë dhe pa kursim; o Nën' e bekuar, e Jesujt që na fali, mëshirë dhe shpëtim.

Ejani o besnikë këtu, le ta hymnojmë, ren' e bukur të qiellit, që vesën e perëndishme, Zotin e ëmbël Jesu, përmi dhen' e zbriti, për ne njerëzit; si ujë të hyjësme, që përpjetë këcen me hov, nxier shkëndija plot me jetë dhe gjallësi, dhe flladit me hir, shkretëtirat e shpirtëve; ujën e gjallë epnaje, që etjen ta shuajmë, me bes' e shpresë vaditna, pa reshtur kurrë dhe pa kursim; o Nën' e bekuar, e Jesujt që na fali, mëshirë dhe shpëtim.

Lum ti o jetëpritis Burim, që kurdoherë, na buron përdëllim dhe hir, shëndet edhe shërime, për çdo lëngatë dhe helm, dhe për çdo shtrëngicë të besnikëve; o drit' e të verbërve, o spastrim i leprozëve, barrë dhe ilaç, për mjerimet e trupeve; rendim pra që të gjithë sot, të biem mëgjunjazi, të na dhurosh përdëllimin, pa reshtur kurrë dhe pa kursim; o Nën' e bekuar, e Jesujt që na fali, mëshirë dhe shpëtim.

LAVDI. Fryni trumbetat me brohori, edhe këceni, rreth Burimit të ujëve, dëfreni me tërë zëmër, se na dhuron përdëllim, Kryezonj' e Shenjtë, dhe Hyjlindëse; ju mbretër dhe ju barinj, dhe ju burra dhe ju o gra, ju o të pasur, dhe të varfër përmblihduni, edhe lypini, tju dhuronjë shërim dhe hir; dritë për t' errësuarin, dhe vesh për të shurdhërin, dhe për të vdekurin jetë, pa

reshtur kurrë dhe pa kursim; o Nën' e bekuar, e Jesujt që na fali, mëshirë dhe shpëtim.

TANI. Ardhi dit' e shenjt' e Ngjalljes. . . .

Pastaj bëhet Përlëshimi i Pashkës. Të Prëmtën, Shërbesa e Mëngjezit nis si pason:

DHJAKU. Beko, o Atë.

PRIFTI: I bekuar është Perëndia ynë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

Pastaj këndohet tri herë Përlëshorja e Pashkës, një herë prej Priftit edhe nga një herë prej të dy Valleve:

PERLESHORJA E PASHKES

KHRISTOS ANESTI

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (3 herë)

Pastaj këndohen pa zë Troparet pasonjëse:

Passi pamë Ngjalljen e Krishtit, le ta adhurojmë Zotin e Shenjtë Jesu të vetëmin të pamëkatmë. E adhurojmë Kryqin tënt o Krisht, edhe e hymnojmë dhe e lavdërojmë Ngjalljen tënde të Shenjtë, se ti je Perëndia ynë, veç teje nukë njohim tjetër, dhe emërojmë emrin tënt. Ejani të gjithë, o besnikë, ta adhurojmë Ngjalljen e Shenjtë të Krishtit; se ja ku ardhi gëzimi në tërë botën me anën e Kryqit. Pra e bekojmë kurdoherë Zotin, edhe hymnojmë Ngjalljen e tij, se duroj Kryqin për ne, dhe e shkeli vdekjen me vdekje. (3 herë)

Kur arthnë Gratë me Marinë përpara agimit, edhe

e gjetnë gurin të rrugullizur, Engjëlli u tha: Si e kërkoni si njeri me të vdekurit, atë që rron në dritën e ameshuar? Rentni dhe lëcitini botës, që Zoti u-ngrit edhe e vrau vdekjen, se është i Biri i Perëndisë, që shpëtoj gjindjen e njerësve.

O i pavdekur që zbritë në varr për ne, dhe e dërmovë Skëterren o Zot përdhe, dhe u-ngjalle si fitimtar o Krisht Perëndi, edhe Grave me myrra u thirre Gëzohuni, dhe u dhurove paqen e qjellit dishepujve, ti që u fale Ngjalljen të rënëve.

Ne varr me trup si njeri, në Ferr me shpirt e dritë si Perëndi, dhe në Parajsë tok me një Kusar, edhe ndënje mi fronin o Krisht, me Atin dhe me Shpirtin Shenjt, botën e mbushi i papërshkruari.

LAVDI: Si jetëprurës na u-tregua, varri yt më i bukur, më i ndriçim se çdo pallat mbretëror, se andej na lindi na buroj, o Krisht Perëndi, ngjallja dhe shpëtim' i shpirtëve.

TANI: Gëzohu o banes' e të Lartit, Virgjëreshë gëzohu, se na linde Zotin Krisht Perëndi, Shpëtimtarin e besnikëve; pra e bekuar je në mes të grave, o Zonjë Hyjlindëse.

KONDONJESI: Mëshiro, o Zot. (40 herë)

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

Ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përqsaje mi Serafim, ti me të vërtetë linde Fjale Perëndinë, pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Beko, o Atë, më emrin e Zotit.

PRIFTI: I bekuar je, o Krisht o Perëndia ynë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

Pastaj thuhet Përlëshorja e Pashkës pa zë:

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. (3 herë)

Këndimet e sipërme thuhën tërë javën e Pashkës në vëndin e Pasdarkave, Mesnatoreve, dhe Orëve. Në mëngjes, pas këtyre këndimeve, Prifti thotë me zë të lartë:

PRIFTI: Lavdi Trinisë së Shenjtë, së bashkëqënshime, dhe së pandarë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

Pastaj këndohet Tropari i Pashkës me Vargjet edhe Kanuni i Pashkës gjer në fundin e Zbritësore VI, pastaj:

SHKURTORJA, T. T. IV

PAS TI IPERMAKHO STRATIGO

O Kryezonjë, Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,

Qe na dhurove, përdëllime të panumërta,

Pa pushuar, pa kursyer, dhe buzëqeshur,

Qe na linde, Jesu Krishtin Perëndi-njeri,

Nga burimi yt flladit-më sot me hirin tënt,

Se po të thërres: Gëzohu, ujë shpëtonjëse.

SHTEPIA

Hyjlindëse Virgjëreshë, që na linde Jesunë, Fjalën

e Perëndisë dhe Atit, forco-ma shpirtin për lavdërimin tënt, me ujën e Burimit Jetëprites, se po të thërres: Gëzohu, ujë shpëtonjëse.

SINAKSARI

Të Prëmtën e Pashkës, kremtojmë dedikatën e Kishës së Kryezonjës sonë dhe Hyjlindëses të Burimit Jetëprites, edhe kujtojmë çudirat e sipërnatyrëshme, që janë bërë në këtë Kishë prej Shën Marisë.

Passi pamë Ngjalljen e Krishtit. . . . (3 herë)

Kur u-ngrit Jesuj prej varrit. . . . (3 herë)

Pastaj vazhdojnë Këngët e Kanunit VII, VIII, dhe IX, Dërgimësorja e Pashkës, dhe e Burimit Jetëprites:

DERGIMESORJA, T. II

Burimi i vërtetë je, Zonjë Perëndilindëse, i ujëve të qiellit, që lajnë çdo lëngatë dhe çdo helm, të trupeve dhe shpirtëve, uj' e gjall' e shpëtimit, o Nëna e Zotit Krisht.

LAVDERIMET, T. T. II

Këndohen gjithësej dymbëdhjetë, domethënë katër të Tingëllit, katër të Shën Marisë, dhe katër të Pashkës:

PAS IKOS TU EFRATHA, T. II.

Lavdërojeni me timpane dhe me valle; lavdërojeni me kordha dhe me strumenta.

Ejani tok këtu, dhe ujë nga Burimi, merrni për të sëmuret, afrohuni me besë, dhe hirin trashëgojeni.

Lavdërojeni me kimbale tingëllonjëse; lavdërojeni me kimbale brohoritëse; çdo frymë le ta lavdëronjë Zotin.

Pusi me jetën plot, Burimi i pavdekur, dhurata dhe shërime, u fal të gjith' atyre, që vijnë plot me bes' e mall.

Ngrehu, o Zot, o Perëndia im; le të lartësohet dora jote; mos i harro të varfërit e tu në funt.

Shpirteve u jep hir, Burim' i Virgjëreshës, dhe trupeve shëndetin, pra ejani të gjithë, në Kishën e Hyjlindëses.

Do të rrëfenj, o Zot, me tërë zemrën time; do t'i lëçit të gjitha çudirat e tua.

Shtëmba me mannën plot, Burimi Jetëpřitës, që na vadit pa reshtur, me ujën e bekuar, pra pini dhe shërohuni.

Pastaj Vargëzimet e Pashkës, Lavdia e Pashkës, dhe Mesha e Shën Joan Gojartit. Në Hyrjen këndohen Troparet e Pashkës, dhe në vënt të Hymnit Trishenjtör thuhet: "Sa u-pagëzuat".

APOSTULLI

Shpirti im madhështon Zotin.

Se e hodhi syrin mi shërbëtoren e përunjur.

Këndimi prej Letrës së Palit për Filipianët.

Vëllezër, kini atë frymë, që ka patur Jesu Krishti, i cili kishte formën e Perëndisë, dhe ishte barabar me Perëndinë, po e zbriti veten e tij aqë sa mori formën e shërbëtorit edhe shëmbëllsinë e njeriut, edhe u-çfaq si njeri nga fytyra, dhe e përunji veten e tij, edhe u-tregua i bindur gjer në vdekje, dhe në vdekje mi Kryqin. Përandaj edhe Perëndia e lartësoj, edhe i dha një emër tjetër, që përpara ati të përgjunjen të gjithë ata, që janë në qjell edhe mi dhe edhe nënë dhenë, edhe çdo

gjuhë të rrëfenjë se Jesu Krishti është Zot për lavdin' e Perëndisë dhe Atit.

UNGJILLI PAS LUKAJT

Më atë kohë, Jesuj hyri në një katunt, edhe një grua, e quajtur Martha, e priti në shtëpinë e vetë. Edhe ajo kishte një motër, të quajtur Maria, e cila ndënji pranë këmbëve të Jesujt edhe dëgjonte fjalët e tij. Edhe Martha mundahej shumë dyke shërbyer, dhe qëndroj dhe tha: "Zot, nukë do të dish që ime-motër më la të vetëm për të shërbyer? Pra, thuaji të më ndihë." Edhe Jesuj u-përgjeq, edhe i tha: "Marthë, Marthë, kujdesesh edhe trubullohesh për shumë gjëra, po vetëm për një gjë është nevojë; dhe Maria zgjodhi pjesën e mirë, e cila nukë do të merret prej saj." Dhe kur po thoshte ay këto, një grua prej turmës ngriti zërin edhe i tha. "Lum' barku që të ka mbajtur, edhe sisët që ke thëthitur." Edhe ay tha: "Jo, po lum' ata, që e dëgjojnë fjalën e Perëndisë dhe e ruajnë."

Në "Veçan Tërëshenjtën," këndohet Zbritesorja IX më Tingëllin e Parë:

MADHESHTIMI I MESHES

O ANGELLOS EVOA

Një Engjëll i thërriste, hirplotes pa pushuar: Gezohu Virgjëreshë, dhe prapë të them Gëzohu, se Biri yt nga varri, u-ngjall të tretën ditë.

Ndriçohu ndriçohu, qytet i ri Jerusalem, se lavdia e Zotit, përmi ty ka lindur sot. Valle këce, dhe gëzohu Sion, ti o Mari, Nën' e Perëndisë, dëfre për Ngjalljen e Birit tënt.

Në Diptiket këndohet:

PAS TIN TIMIOTERAN

T. T. II. Ujën jetëprurëse që shëron, mannën e bekuar, edhe vesën që na ringjall, dhe renë qjellore, edhe verën e Parajsës, dhe mjaltën që prej shkëmbit, me besë nderojeni.

KUNGATORJA

Trupin e Krishtit e kungoni, burimin e pavdekur e ngjëroni. Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të "Pamë Dritën" edhe "Emri i Zotit," këndohet Përlëshorja e Pashkës. Në fundin e Meshës bëhet Përlëshimi i Pashkës.